



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, dhe nenit 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2023 të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

PËR CAKTIMIN E VEPRIMEVE TË PËRKOHËSHME PËR TRAJTIMIN E OBJEKTEVE TË MBYLLURA SHKOLLORE

I . Me këtë Vendim përcaktohen veprimet për trajtimin e përkohshëm të objekteve shkollore të mbyllura sipas Rekomandimit të MASHT për shkak të numrit të vogël të nxënësve.

II. Objektet shkollore të cilat do të trajtohen në këtë fazë janë:

- Objekti shkollos SHFMU "Zenel Hajdini" paralelja e ndarë fizike në Vrellë të Gadimes,
- Objekti shkollos SHFMU "Fehmi Agani" paralelja e ndarë fizike në Vrellë të Goleshit
- Objekti shkollos "SHFMU " Drita " paralelja e ndarë fizike në Kojskë

III. Me qëllim të mosdëmtimit dhe shkatërrimit të tyre, objektet shkollore destinohen për përdorim për nevojat e arsyeshme të banorëve të fshatit të karakterit të përgjithshëm .

IV. Për menaxhimin e objekteve të cekura shkollore do të kujdeset Këshilli i fshatit përkatës .

V. Për procedurën e transferimit të objekteve të cekura tek Këshillat e fshatrave do të kujdeset Drejtorati për Arsim.

VI Objektet shkollore do të lejohen të përdorën nga banorët për një (1) ose disa ditë me Pëlqimin e Këshillit të fshatit dhe vetëm për aktivitetete që nuk bijnë në kundërshtim me rendin dhe sigurinë publike.

VII. Menaxhimi i objekteve shkollore nga Këshillat e fshatrave përkatëse do të jetë i përkohshëm deri në marjen e ndonjë Vendimi tjetër nga Komuna.

VIII. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim.

IX. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim – Vendimi është përcaktuar me dispozitat nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, dhe nenit 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Me datë 06.10.2023, Drejtorati për Arsim i ka parashtruar kërkesë Kryetarit të Komunës në të cilën ka theksuar që në bazë të rekomandimeve të MASHT është bërë ristrukturimi i tri shkollave si pasojë e të cilës tri objekte shkollore kanë mbetur të zbrazëta dhe ekziston rreziku potencial se ato objekte mund të dëmtohen . Përkitazi me këtë Drejtori I DKA –së ka kërkuar trajtimin e kësaj çështje nga na e Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal

Nga arsyet e cekura dhe në pajtim me dispozitat ligjore, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 351/09-64356
Lipjan, Më 16.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVO
MUNICIPALITY OF LIPJAN



Pranuar me Priljeje:	06.10.2023	
Njësia Jednica:	Nr.:	Shtojca Dodatak:
01-610/01-57391		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DATE /A:	06.10.2023
REFERENCË:	
PËR :	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit të Arsimit në Lipjan
LËNDA :	Kërkesë



I Nderuar Kryetar,

Bazuar në rekomandimet e MASHT-it, Komuna e Lipjanit respektivisht Drejtoria e Arsimit ka marr vendim për rristrukturimin e disa shkollave ku kemi fuzionim të disa shkollave pnf në shkolla amë. Ky rristrukturim përfshin shkollat “Zenel Hajdini” pnf në Vrellë e Gadimës, “Fehmi Agani” pnf në Vrellë e Goleshit dhe “Drita” pnf në Kojksë. Me këtë rast neve na duhet ndihma e Juaj dhe e Kuvendit Komunal se si të veprojmë me objektet në këto tri fshatra në mënyrë që të mos demtohen.

p.s Ekipet e caktuara nga drejtoret respektiv të shkollave kanë bërë rexhistrimin e aseteve në ato shkolla dhe nxënësit janë duke vazhduar mësimin në shkollat amë me transport të siguar nga Komuna

Ju falemnderit për bashkëpunim!